

Tiranë, më datë 21.02.2025

ANKIM

ANKUES: Qendra “Qëndresa Qytetare”, një organizatë jofitimprurëse e regjistruar me Vendimin Nr. 1120, datë 15.09.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me seli në adresën: Rruga “Ali Pashë Gucia”, Pallati nr. 42 me adresë elektronike qendresaqytetare@gmail.com, me Drejtor Ekzekutiv Z. Rigels Xhemollari, përfaqësuar me autorizim nga **Z. Dhimitër Zguro**.

DREJTUAR: Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve.

OBJEKTI:

1. Shfuqizimi i Vendimit nr. 129, datë 20.02.2025, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
2. Vendosja e sanksionit administrativ ndaj personit përgjegjës për raportimin në Kryeministri.
3. Vendosja e sanksionit administrativ ndaj Kryeministrit.

BAZA LIGJORE: Nenet 92, 124/1 dhe 171, të Ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar.
Nenet 3 dhe 10, të Vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, të ndryshuar.

Të nderuar anëtarë të Komisionit të Ankimimeve dhe Sanksioneve,

Më datë 20.02.2024, jemi njohur me Vendimin nr. 129, datë 20.02.2025, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, nëpërmjet të cilit, është vendosur “Mospranimi i kërkesës së Organizatës Qendra ‘Qëndresa Qytetare’, për ndalimin e veprimtarisë publike, ‘Takim i Kryeministrit me punonjësit e Bashkisë Tiranë’”. Duke mos qenë aspak dakord me këtë vendimmarrje të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve brenda afatit ligjor të parashikuar në nenin 124/1, të Kodit Zgjedhor, paraqesim këtë ankim bazuar në faktet, të drejtën e aplikueshme dhe analizën ligjore si vijon:

I. RRETHANAT E FAKTIT

1. Më datë 20.02.2025, Qendra “Qëndresa Qytetare” njoftuar përmes platformave të komunikimit elektronik dhe mediave të ndryshme¹ se, në të njëjtën datë, në orën 16:30, Kryeministri do të zhvillonte një takim me punonjësit e Bashkisë Tiranë. Të dhënat e publikuara tregonin se, në këtë takim do të merrnin pjesë në mënyrë të organizuar dhe të detyruar e gjithë administrata e Bashkisë Tiranë, dhe secili prej drejtorive apo institucioneve në varësi të saj, do të mbajë përgjegjësi për vërtetësinë e numrit të stafit të pranishëm.²

2. Nga verifikimi ynë në Ndërfaqen Elektronike të Raportimit të Institucioneve (“NRI”), rezultoi se kjo veprimtari publike nuk ishte raportuar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve [Prova 1 – Raporti i të dhënave mbi aktivitetet publike të administratës shtetërore të raportuara për t’u zhvilluar në datën 20.02.2025 në Ndërfaqen Elektronike të Raportimit të Institucioneve]. Në të tilla kushte, duke qenë se veprimtaria kishte një karakter publik, do të ishte e hapur për mediat dhe publikun, më konkretisht, në të do të merrnin pjesë të gjithë punonjësit e Bashkisë dhe institucioneve në varësi të saj, Qendra “Qëndresa Qytetare” i kërkoi në orën 13:22, në rrugë elektronike, fillimisht përmes adresës elektronike “denoncime@kqz.gov.al”, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, ndalimin e veprimtarisë publike [Prova nr. 2 – E-mail me subjekt “Kërkesë urgjente për ndalimin e veprimtarisë publike” drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve]. E njëjta kërkesa është paraqitur në rrugë elektronike tek adresa elektronike “institucione@kqz.gov.al” në orën 13:22 [Prova nr. 3 – E-mail nga qendresaqytetare@gmail.com drejtuar institucione@kqz.gov.al, ora 13:22].

3. Në vijim, në orën 13:33, Qendra “Qëndresa Qytetare” i ka dërguar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, nën të njëjtin *thread*, e-mail me përmbajtje si vijon: “Sqarojmë se, aktiviteti i denoncuar nga ana jonë nuk është i njëjti me veprimtarinë publike të raportuar me titullin ‘Bashkia e Tiranës organizon ditën e enjte, 20.02.2025, Ceremoninë e Hapjes ‘Tirana, Kryeqyteti Mesdhetar i Kulturës dhe Dialogut 2025’, kjo pasi adresa e veprimtarisë së raportuar është Teatri Kombëtar i Operas dhe Baletit, dhe folësit kryesorë janë të përcaktuar, ndërsa nuk pritet që të ketë pjesëmarrës të tjerë, sipas shënimit përkatës. Ndërkohë që, sikundër rezulton nga mediat dhe të dhënat publike, aktiviteti i orës 16:30, është një aktivitet i hapur, me pjesëmarrës punonjësit e Bashkisë Tiranë’.” [Prova nr. 4 – E-mail nga qendresaqytetare@gmail.com drejtuar institucione@kqz.gov.al, ora 13:33].

¹<https://euronews.al/rama-takim-me-punonjesit-e-bashkise-se-tiranes-i-mbledh-ne-sheshin-skenderbej/>; <https://www.balkanweb.com/arrestimi-i-veliajt-rama-do-mbledhe-ne-oren-1630-punonjesit-e-bashkise-ne-sheshin-skenderbej/#gsc.tab=0>; <https://www.syri.net/politike/764602/krim-zgjedhor-rama-mbledh-me-force-per-miting-punonjesit-e-bashkise-se-tiranes-ne-sheshin-skenderbej/>; <https://www.vizionplus.tv/rama-nxjerr-ne-shesh-bashkine-takim-i-hapur-me-te-gjithe-punonjesit-pas-arrestimit-te-veliajt/>; <https://top-channel.tv/2025/02/20/rama-mbledh-punonjesit-e-bashkise-ne-sheshin-skenderbej02/etj>.

² <https://joq-albania.com/artikull/1256344.html>



2


4. Në të njëjtën datë, në orën 16:00, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka marrë Vendimin nr. 129, datë 20.02.2025 [**Prova nr. 5 – Vendimi Nr. 129, datë 20.02.2025**]. Ky Vendim i është komunikuar Qendrës “Qëndresa Qytetare” në rrugë elektronike në orën 16:27, të së njëjtës datë [**Prova nr. 6 – Komunikimi elektronik i Vendimit nr. 129, datë 20.02.2025**].

4.1. Duke iu referuar këtij Vendimi, më datë 14.02.2025, personi përgjegjës për raportimet të institucionit të Kryeministrisë, ka raportuar në përputhje me afatet ligjore të parashikuara në Kodin Zgjedhor, dy veprimtari me tematika si vijon: “1. Inagurimi i Spitalit të Pediatriisë në Qendrën Spitalore Universitare Tiranë ‘Nënë Tereza’. Aktiviteti do të zhvillohet në 20.2.2025, ora 10:00. Vendi i zhvillimit të veprimtarisë: Njësia administrative nr. 3. Në këtë aktivitet është ftuar të marrë pjesë edhe Kryeministri i vendit, Z. Edi Rama. Zhvillimi këtij aktiviteti është raportuar në datë 14.2.2025. 2. Ceremonia e Hapjes ‘Tirana, Kryeqyteti Mesdhetar i Kulturës dhe Dialogut 2025’. Në këtë ceremoni janë ftuar të marrin pjesë autoritete vendase dhe të huaj, ceremoni në të cilën do të jetë i pranishëm si i ftuar edhe Kryeministri i vendit Z. Edi Rama. Veprimtaria është raportuar në datë 14.2.2025 për tu zhvilluar në datë 20.2.2025, ora 16:00, Vendi i zhvillimit të veprimtarisë: TKOB, njësia administrative nr. 2.”.

4.2. Po ashtu, sipas këtij Vendimi, më datë 19.02.2025, personi përgjegjës për raportimet në Kryeministri, më datë 19.02.2025, ka njoftuar ndryshime për të dyja veprimtaritë e planifikuara, dhe më konkretisht, për veprimtarinë e dytë, Ceremoninë e Hapjes së “Tirana, Kryeqyteti Mesdhetar i Kulturës dhe Dialogut 2025”, ka informuar se, vendndodhja e aktivitetit do të ishte Sheshi “Skënderbej”, ndërsa orari i aktivitetit do të spostohej për në orën 16:30.

5. Duke argumentuar si më sipër, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mënyrë të gabuar është shprehur me vendim, mbi çështje të ndryshme nga ato, që përbënin objektin e kërkesës së Qendrës “Qëndresa Qytetare”. Ky fakt provohet katërcipërisht dhe nga vetë përmbajtja e aktivitetit, të zhvilluar në Sheshin “Skënderbej”, i cili nuk kishte asnjë të përbashkët me Ceremoninë e Hapjes së “Tirana, Kryeqyteti Mesdhetar i Kulturës dhe Dialogut 2025”.

5.1. Sikundër provohet nga transmetimi i aktivitetit të paralajmëruar në media, për të cilin ka qenë edhe kërkesa jonë, takimi është hapur nga Nënkrjetarja e Bashkisë, Znj. Anuela Ristani. Në mënyrë të përmbledhur, ajo falenderon Kryeministrin për takimin, citojmë, të zhvilluar në qiell të hapur, për të mbledhur veten nga ngjarjet, si dhe mungesa e Kryetarit, e cila në vështrim të saj, përbën një sfidë për mbarëvajtjen e punëve publike. Në tërësi, fjalimi i saj adreson mungesën e Kryetarit të Bashkisë, si pasojë e caktimit të masës së sigurimit “Arrest me burg” nga Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.



5.2. Ndërsa Kryeministri e hapi fjalën e tij, duke u shprehur si vijon: “Të dashur punonjës së bashkisë së Tiranës e kërkoja këtë mbledhje me të gjithë ju sepse gjatë këtyre ditëve kam parë mes jush, por edhe mes shumë të tjerësh njerëz të prekur, njerëz të lënduar, të zhgënjyer, të dëshpëruar. Disa nga ju shkuan dhe tek dera e Gjykatës Speciale për të protestuar ditën që Kryetari i Bashkisë u la në burg pa gjyq.”. Në fjalimin e tij janë mbajtur qëndrime të ngjashme, edhe të një natyre politike, duke përdorur veprimtarinë publike, edhe për të zhvilluar propagandë elektorale.³

II. E DREJTA E APLIKUESHME

6. Kodi Zgjedhor:

- (i) **Neni 92** parashikon: “1. Institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, janë të detyruara të raportojnë në KQZ të gjitha veprimtaritë me karakter publik që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve. Formojnë veprimtari publike të gjitha veprimtaritë që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut apo të medias, si dhe ato që kanë në agjendë informimin, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve, e publikut rreth tyre. 2. Raportimi është përgjegjësi personale e personit përgjegjës për drejtimin administrativ të institucioneve publike, agjencive dhe ndërmarrjeve shtetërore (...) 4. Në rast se KQZ-ja, kryesisht ose me kërkesë të të tretëve, konstaton nga informacioni, sipas pikës 3 të këtij neni, se veprimtaria mund të përbëjë keqpërdorim të burimeve shtetërore, atëherë ajo urdhëron ndalimin e zhvillimit të saj. Ndalimi kryhet nëpërmjet vendosjes së shënimit “Ndaluar nga KQZ-ja” në ndërfaqen e raportimit, në pjesën që i takon veprimtarisë. Shënimi “Ndaluar nga KQZ-ja” vendoset jo më vonë se dy ditë përpara afatit të planifikuar për zhvillimin e veprimtarisë. (...) 6. Mosraportimi i veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, agjencive dhe/ose ndërmarrjeve shtetërore, ose zhvillimi i tyre, pavarësisht ndalimit nga KQZ-ja ngarkon me përgjegjësi personin përgjegjës, si dhe titullarin përkatës të institucionit kur ai ka pënuar zbatimin e kësaj dispozite.”.
- (ii) **Neni 124/1** parashikon: “2. Kundër akteve të Komisionerit lejohet ankimi në rrugë administrative në KAS nga palët që demonstrojnë një interes të ligjshëm për çështjen objekt i ankimit. Në periudhën nga dalja e dekretit të Presidentit të Republikës për zhvillimin e zgjedhjeve deri në shpalljen e rezultatit përfundimtar, ankimi

³<https://www.kryeministria.al/newsroom/fjala-e-kryeministrit-rama-ne-takimin-me-punonjesit-e-bashkise-se-tiranes/>

paraqitet brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit. Për periudhën tjetër, ankimi paraqitet brenda 30 ditëve nga dalja e vendim.”.

- (iii) **Neni 171** parashikon: *“1. Shkelja e dispozitave të këtij Kodi nga anëtarët e komisioneve të zgjedhjeve ose nga persona të ngarkuar me detyra, sipas këtij Kodi, kur nuk përbën vepër penale, dënohet me gjobë nga 3 000 deri në 90 000 lekë.”.*

III. ANALIZA LIGJORE

A. Në lidhje me shfuqizimin e Vendimit nr. 129, datë 20.02.2025:

7. Referuar pikës 1, të nenit 92, të Kodit Zgjedhor, institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërmarrjet shtetërore, janë të detyruara të raportojnë në KQZ të gjitha veprimtaritë me karakter publik që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve. Në kuadër të këtij detyrimi, Kodi Zgjedhor ka parashikuar dhe kuptimin e veprimtarive publike. Kështu, sipas Kodit Zgjedhor, formojnë veprimtari publike të gjitha veprimtaritë që janë të hapura për pjesëmarrjen e publikut apo të medias, si dhe ato që kanë në agjendë informimin, në periudhën katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve, e publikut rreth tyre.

8. Së pari, në rastin konkret, ndryshe nga sa pretendon Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, aktiviteti publik i organizuar në orën 16:30, për të cilin Qendra “Qëndresa Qytetare” kërkoi ndalimin, nuk është i njëjtë, me aktivitetin për të cilin është kryer raportimi. Kjo sepse, aktiviteti për të cilin është kërkuar ndalimi zhvillohej në Sheshin “Skënderbej” dhe lidhej me takimin e Kryeministrit me punonjës të Bashkisë Tiranë. Këto të dhëna, me të cilat jemi njohur përmes mediave, ishin të ndryshme nga të dhënat e aktivitetit të raportuar. Ky i fundit, kishte të bënte me Ceremoninë e Hapjes së “Tirana, Kryeqyteti Mesdhetar i Kulturës dhe Dialogut 2025”, do të zhvillohej në ambientet e TKOB dhe do të kishte si pjesëmarrës, krahas Kryeministrit, edhe Ministrin e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Drejtorit të Fondacionit Anna Lindh Foundation dhe Ambasadorit të Egjiptit në Tiranë [Prova nr. 7 – Të dhënat e veprimtarisë përkatëse të pasqyruara në NRI].

9. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve shprehet se: *“Nëpërmjet postës elektronike personi përgjegjës për raportimet të institucionit të Kryeministrit në datë 19.2.2025 ka njoftuar në lidhje me veprimtarinë e dytë “Ceremonia e Hapjes “Tirana, Kryeqyteti Mesdhetar i Kulturës dhe Dialogut 2025” se: “Për shkak të afërsisë së eventit është e pamundur ndryshimi në sistem i vendit ku do organizohet aktiviteti. Nga TKOB, vendndodhja e zhvillimit do të jetë Sheshi “Skënderbej”, në orën 16:30, po në njësinë administrative nr. 2”. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pavarësisht kohës së shkurtër në dispozicion, në vend që të kryente një hetim administrativ, qoftë edhe bazuar vetëm mbi provat e paraqitura nga kërkuesi, ka marrë të mirëqenë komunikimin e personit përgjegjës*

për raportimin në Kryeministri, duke shkelur në mënyrë flagrante nenin 92, të Kodit Zgjedhor.

10. Pavarësisht faktit se Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve pavarësisht se ka patur në dispozicion të gjithë provat e nevojshme, dhe sqarimeve shtesë të Qendrës “Qëndresa Qytetare” se, aktiviteti për të cilin kërkohet ndalimi është i ndryshëm nga aktivitetet e raportuara nga Kryeministria, në mënyrë të gabuar ka mbajtur qëndrimin se, ky aktivitet është i njëjti me ato të raportuara. Ndonëse në dijeni të plotë mbi një veprimtari publike të pa raportuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve jo vetëm që ka vendosur të rrëzojë kërkesën për ta ndaluar atë, por madje në tejkalim të kompetencave që ligji i njej dhe në kundërshtim me provat e administruara, e ka pranuar veprimtarinë si të raportuar.

11. Së dyti, edhe sikur të ndodheshim përballë të njëjtës veprimtari publike, Komisioneri përmes vendimmarrjes së tij, ka shkelur sërish legjislacionin zgjedhor. Në referim të pikës 6, të nenit 5, të Vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, të dhënat e raportimit nuk mund të modifikohen në periudhën pesë ditë përpara datës së zhvillimit të aktivitetit deri në datën e zhvillimit të tij. Pavarësisht këtij ndalimi kategorik, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka pranuar modifikimin e një veprimtarie të raportuar vetëm dy ditë përpara zhvillimit të saj. Gjithashtu, sipas Fjalorit të Gjuhës Shqipe, fjala “modifikim” nënkupton ndryshimin e trajtës a të diçkaje pa ia ndërruar thelbin, natyrën, duke i bërë ndryshime të pjesshme. Ndërsa në rastin konkret, sikundër është përmendur edhe më sipër, nuk kemi të bëjmë me një ndryshim të pjesshëm, por me një ndryshim tërësor të thelbit të veprimtarisë publike, nga një Ceremoni Hapjeje në një takim publik me punëmarrësit e institucionit, për t’ju ofruar atyre mbështetje, citojmë Kryeministrin dhe Nënkryetaren e Bashkisë, në këto kohë të vështira.

12. Së treti, edhe sikur të pranojmë argumentimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, mbi modifikimin e veprimtarisë së raportuar, sërish kemi të bëjmë me dy veprimtari publike të ndryshme, që zhvillohen në të njëjtën vendndodhje dhe në të njëjtin orar. Megjithatë, sikundër rezulton, asnjë aktivitet në lidhje me Ceremoninë e Hapjes së “Tirana, Kryeqyteti Mesdhetar i Kulturës dhe Dialogut 2025” nuk është zhvilluar në Sheshin “Skënderbej”, në orën 16:30. Përkundrazi, e vetmja veprimtari publike e zhvilluar ka qenë ajo e takimit të Kryeministrit me punonjësit e Bashkisë Tiranë, e cila nuk është raportuar në Ndërfaqen Elektronike të Raportimit NRI, në kundërshtim me nenin 92, të Kodit Zgjedhor.

13. Përsa më sipër, duke qenë se veprimtaria në fjalë ka qenë e hapur për mediat dhe për publikun, pra për punëmarrësit e Bashkisë së Tiranës dhe institucioneve a ndërrmarrjeve në varësi të saj, të cilët në formë të organizuar dhe të detyruar kanë marrë pjesë në këtë veprimtari, gjatë periudhës katër mujore përpara datës së zgjedhjeve, dhe zhvillimi i saj nuk është raportuar, Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve duhet të vendosë shfuqizimin e Vendimit nr. 129, datë 20.02.2025, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.



B. Në lidhje me vendosjen e sanksionit administrativ ndaj personit përgjegjës për raportimin:

14. Referuar pikës 3, të nenit 92, të Kodit Zgjedhor, raportimi është përgjegjësi personale e personit përgjegjës për drejtimin administrative të institucioneve publike, agjencive dhe ndërmarrjeve shtetërore. Mosraportimi i veprimtarive me karakter publik të institucioneve, në referim të nenit 6, të nenit 92, të Kodit Zgjedhor, ngarkon me përgjegjësi administrative personin përgjegjës, si dhe titullarin përkatës të institucionit kur ai ka penguar zbatimin e kësaj dispozite.

15. Në rastin konkret, personi përgjegjës për raportimin në Kryeministri jo vetëm që nuk ka kryer raportimin e veprimtarisë publike, por edhe ka keqinformuar në lidhje me veprimtaritë e planifikuara për t'u zhvilluar nga institucioni i Kryeministrit, në kundërshtim të hapur dhe flagrant me nenin 92, të Kodit Zgjedhor. Për rrjedhojë, personi përgjegjës duhet të ngarkohet me përgjegjësi administrative sipas përcaktimit të pikës 1, të nenit 171, të Kodit Zgjedhor.


16. Duke mbajtur në konsideratë rrethanat në të cilat është kryer shkelja e nenit 92, të Kodit Zgjedhor, faktet se veprimtaria publike nuk është raportuar nga personi përgjegjës; dhe se pjesëmarrja e publikut në të, sipas të dhënave të publikuara në media të ndryshme, ka qenë e organizuar dhe në mënyrë të detyrueshme, si dhe rëndësinë e shkeljes administrative, kërkojmë që ndaj personit përgjegjës të vendoset sanksioni administrativ në masën prej 90,000 Lekë.

C. Në lidhje me vendosjen e sanksionit administrativ ndaj Kryeministrit:

17. Mosraportimi i veprimtarive me karakter publik të institucioneve publike, ngarkon me përgjegjësi administrative edhe titullarin përkatës të institucionit kur ai ka penguar zbatimin e detyrimit për raportim. Edhe në këtë rast, përgjegjësia administrative i referohet pikës 1, të nenit 171, të Kodit Zgjedhor, pasi titullarët e institucionave kanë detyrimin që të mos pengojnë raportimin e veprimtarive publike.

18. Në rastin konkret, Kryeministri, me veprime konkrete, përmes organizimit të një veprimtarie publike të paralajmëruar vetëm një ditë më herët, ka penguar, qoftë edhe në mënyrë të tërthortë, raportimin e veprimtarisë publike, megjithëse ai ka patur në dispozicion të gjitha mundësitë që të njëjtën veprimtari ta zhvillonte dhe në një datë tjetër, duke respektuar nenin 92, të Kodit Zgjedhor.

19. Nën të njëjtin arsyetim si në paragrafin 16, të këtij Ankimi, kërkojmë që duke mbajtur në konsideratë dhe kriteret për caktimin e llojit dhe të masës së dënimit, në referim të nenit 18, të Ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për kundërvajtjet administrative", kërkojmë që ndaj Kryeministrit të vendoset sanksioni administrativ në masën prej 90,000 Lekë për shkak të pengimit për raportimin e veprimtarisë publike.

7


IV. KONKLUZIONE


20. Përsa më sipër, mbështetur në nenet 92, 124/1 dhe pikën 1, të nenit 171, të Kodit Zgjedhor dhe në nenet 3 dhe 10, të Vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencie, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, të ndryshuar, përfundimisht,

KËRKOJMË

1. Shfuqizimin e Vendimit nr. 129, datë 20.02.2025, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
2. Vendosja e sanksionit administrativ ndaj personit përgjegjës për raportimin në Kryeministri.
3. Vendosja e sanksionit administrativ ndaj Kryeministrit.

Me konsideratë,

Për “QËNDRESA QYTETARE”



Dhimitër ZGURË

Bashkëlidhur gjeni:

- (i) Prova 1 – Raporti i të dhënave mbi aktivitetet publike të administratës shtetërore të raportuara për t’u zhvilluar në datën 20.02.2025 në Ndërfaqen Elektronike të Raportimit të Institucioneve;
- (ii) Prova nr. 2 – E-mail me subjekt “Kërkesë urgjente për ndalimin e veprimtarisë publike” drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;
- (iii) Prova nr. 3 – E-mail nga qendresaqytetare@gmail.com drejtuar institucione@kqz.gov.al, ora 13:22;
- (iv) Prova nr. 4 – E-mail nga qendresaqytetare@gmail.com drejtuar institucione@kqz.gov.al, ora 13:33;
- (v) Prova nr. 5 – Vendimi Nr. 129, datë 20.02.2025;
- (vi) Prova nr. 6 – Komunikimi elektronik i Vendimit nr. 129, datë 20.02.2025;
- (vii) Prova nr. 7 – Të dhënat e veprimtarisë përkatëse të pasqyruara në NRI.

Data e veprimtarisë	Ora e veprimtarisë	Lloji i veprimtarisë	Tematika	Institucioni	Dt. Regjistrimi
20-02-2025	09:00	Tjetër	Arsim	MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT	14-02-2025 20:14
20-02-2025	10:00	Inagurim	Shëndetësi	KRYEMINISTRIA	14-02-2025 17:56
20-02-2025	16:00	Tjetër	Kulturë	KRYEMINISTRIA	14-02-2025 17:36
20-02-2025	10:00	Inagurim	Shëndetësi	MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE	14-02-2025 15:46
20-02-2025	10:00	Tryezë diskutimesh	Tjetër	MINISTRI I SHETIT PËR PUSHTETIN VENDOR	14-02-2025 14:31
20-02-2025	10:00	Informim/ndërgjegjësim	Çështje sociale	QENDRA E PARANDALIMIT TË KRIMEVE TË TË MITURVE DHE TË RINJVE	14-02-2025 10:17
20-02-2025	18:00	Tjetër	Tjetër	BASHKIA ROSKOVEC	13-02-2025 15:29
20-02-2025	13:00	Tjetër	Tjetër	MINISTRI I SHETIT PËR RININË DHE FËMIJËT	12-02-2025 11:10
20-02-2025	11:00	Tryezë diskutimesh	Tjetër	MINISTRIA PËR EVROPËN DHE PUNËT E JASHTME	11-02-2025 15:54
20-02-2025	10:00	Tryezë diskutimesh	Tjetër	AGJENCIA SHETËRORE E PROGRAMIMIT STRATEGJIK DHE KOORDINIMIT TË NDIHMËS	11-02-2025 15:11
20-02-2025	18:00	Tjetër	Kulturë	AGJENCIA PËR DIALOG DHE BASHKËQEVERISJE	07-02-2025 13:54
20-02-2025	13:30	Informim/ndërgjegjësim	Drejtësi	MINISTRIA E DREJTËSISË	06-02-2025 14:29
20-02-2025	11:00	Informim/ndërgjegjësim	Tjetër	DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PRONËSISË INDUSTRIALE	05-02-2025 14:00

Kërkesë urgjente për ndalimin e veprimtarisë publike

4 messages

Qendresa Qytetare <qendresaqytetare@gmail.com>

20 February 2025 at 13:19

To: denoncime@kqz.gov.al

Cc: Dhimitër Zguro <dhimiterzguro@gmail.com>

Të nderuar,

Ju lutem, gjeni bashkëlidhur kërkesën për ndalimin e veprimtarisë publike, takim i Kryeministrit me punonjësit e Bashkisë Tiranë.

Për shkak të ngutshmërisë që ekziston si pasojë e zhvillimit të takimit ditën e sotme, kërkohet marrjen e menjëhershme të masave përkatëse.

Me konsideratë,



QËNDRESA QYTETARE

Rruga "Ali Pashë Gucia 1", Tiranë

w: www.qq.com.ale: qendresaqytetare@gmail.com

2 attachments

 **1. Kërkesë urgjente për ndalimin e veprimtarisë publike, takim i Kryeministrit me punonjësit e Bashkisë Tiranë..pdf**
232K

 **2. AktiviteteAktive_20250220.xlsx**
4K

Qendresa Qytetare <qendresaqytetare@gmail.com>

20 February 2025 at 13:22

To: institucione@kqz.gov.al

Të nderuar,

Ju lutem, gjeni bashkëlidhur kërkesën për ndalimin e veprimtarisë publike, takim i Kryeministrit me punonjësit e Bashkisë Tiranë.

Për shkak të ngutshmërisë që ekziston si pasojë e zhvillimit të takimit ditën e sotme, kërkohet marrjen e menjëhershme të masave përkatëse.

Me konsideratë,



QËNDRESA QYTETARE

Rruga "Ali Pashë Gucia 1", Tiranë
w: www.qq.com.al
e: qendresaqytetare@gmail.com



2 attachments



1. Kërkesë urgjente për ndalimin e veprimtarisë publike, takim i Kryeministrit me punonjësit e Bashkisë Tiranë..pdf
232K



2. AktiviteteAktive_20250220.xlsx
4K

Qendresa Qytetare <qendresaqytetare@gmail.com>
To: institucione@kqz.gov.al

20 February 2025 at 13:33

Përshëndetje,

Sqarojmë se, aktiviteti i denoncuar nga ana jonë nuk është i njëjti me veprimtarinë publike të raportuar me titullin "Bashkia e Tiranës organizon ditën e enjte, 20.02.2025, Ceremoninë e Hapjes "Tirana, Kryeqyteti Mesdhetar i Kulturës dhe Dialogut 2025", kjo pasi adresa e veprimtarisë së raportuar është Teatri Kombëtar i Operas dhe Baletit, dhe folësit kryesorë janë të përcaktuar, ndërsa nuk pritet që të ketë pjesëmarrës të tjerë, sipas shënimit përkatës.

Ndërkohë që, sikundër rezulton nga mediat dhe të dhënat publike, aktiviteti i orës 16:30, është një aktivitet i hapur, me pjesëmarrës punonjësit e Bashkisë Tiranë.

Më të mirat,



QËNDRESA QYTETARE

Rruga "Ali Pashë Gucia 1", Tiranë
w: www.qq.com.al
e: qendresaqytetare@gmail.com



On Thu, 20 Feb 2025 at 13:22, Qendresa Qytetare <qendresaqytetare@gmail.com> wrote:

Të nderuar,

Ju lutem, gjeni bashkëlidhur kërkesën për ndalimin e veprimtarisë publike, takim i Kryeministrit me punonjësit e Bashkisë Tiranë.

Për shkak të ngutshmërisë që ekziston si pasojë e zhvillimit të takimit ditën e sotme, kërkojmë marrjen e menjëhershme të masave përkatëse.

Me konsideratë,



QËNDRESA QYTETARE

Rruga "Ali Pashë Gucia 1", Tiranë
w: www.qq.com.al
e: qendresaqytetare@gmail.com



Institucione <institucione@kqz.gov.al>
To: Qendresa Qytetare <qendresaqytetare@gmail.com>

20 February 2025 at 16:27

Përshëndetje!

Bashkëlidhur gjeni për njohje Vendimin nr.129, datë 20.2.2025, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, "Për shqyrtimin e kërkesës së datës 20.2.2025, të Organizatës Qendra "Qëndresa Qytetare".

Faleminderit!

From: Qendresa Qytetare <qendresaqytetare@gmail.com>
Sent: Thursday, February 20, 2025 1:33 PM
To: Institucione <institucione@kqz.gov.al>
Subject: Re: Kërkesë urgjente për ndalimin e veprimtarisë publike

You don't often get email from qendresaqytetare@gmail.com. Learn why this is important

KUJDES: Ky është një email i ardhur nga jashtë adresave zyrtare qeveritare. Mos klikoni URL-të ose bashkëlidhjet nëse nuk e njihni dhe/ose nuk i besoni dërguesit.

Përshëndetje,

Sqarojmë se, aktiviteti i denoncuar nga ana jonë nuk është i njëjti me veprimtarinë publike të raportuar me titullin "Bashkia e Tiranës organizon ditën e enjte, 20.02.2025, Ceremoninë e Hapjes "Tirana, Kryeqyteti Mesdhetar i Kulturës dhe Dialogut 2025", kjo pasi adresa e veprimtarisë së raportuar është Teatri Kombëtar i Operas dhe Baletit, dhe folësit kryesorë janë të përcaktuar, ndërsa nuk pritet që të ketë pjesëmarrës të tjerë, sipas shënimit përkatës.

Ndërkohë që, sikundër rezulton nga mediat dhe të dhënat publike, aktiviteti i orës 16:30, është një aktivitet i hapur, me pjesëmarrës punonjësit e Bashkisë Tiranë.

Më të mirat,



QËNDRESA QYTETARE

Rruga "Ali Pashë Gucia 1", Tiranë
w: www.qq.com.al
e: qendresaqytetare@gmail.com




On Thu, 20 Feb 2025 at 13:22, Qendresa Qytetare <qendresaqytetare@gmail.com> wrote:

Të nderuar,

Ju lutem, gjeni bashkëlidhur kërkesën për ndalimin e veprimtarisë publike, takim i Kryeministrit me punonjësit e Bashkisë Tiranë.

Për shkak të ngutshmërisë që ekziston si pasojë e zhvillimit të takimit ditën e sotme, kërkojmë marrjen e menjëhershme të masave përkatëse.

Me konsideratë,



QËNDRESA QYTETARE

Rruga "Ali Pashë Gucia 1", Tiranë
w: www.qq.com.al
e: qendresaqytetare@gmail.com



**KURSEJMË
ENERGJINË
QË TA KEMI!**

Informacioni i trasmetuar në përmbajtje të këtij mesazhi është i destinuar vetëm për individin ose për institucionin të cilit i është nisur, mund të përmbajë materiale konfidenciale dhe / ose të privilegjuara vetëm për marrësin. Çdo rishikim, trasmetim, shpërndarje apo kryerje e ndonjë veprimi tjetër të ngjashëm me këto, nga personat apo nga subjekte të tjera të ndryshme nga marrësi i synuar, është i ndaluar. Nëse merrni gabimisht këtë mesazh, ju lutem kontaktoni urgjentisht dërguesin e tij dhe fshini çdo material të trasmetuar në kompjuterin tuaj. Ne nuk pranojmë asnjë detyrim lidhur me dëmtimin apo humbjen e shkaktuar nga programe të dëmshme apo nga viruse, përveç rastit të neglizhencës së plotë, apo sjelljes së gabuar dhe të qëllimshme.

The information transmitted in the content of this message is intended only for the individual or the institution to whom it is addressed, may contain confidential and/or privileged material for the recipient only. Each review, transmission, distribution or performance of any other action similar to these, by persons or by entities other than the intended recipient, is prohibited. If you receive this message in error, please contact the sender immediately and delete any transmitted material on your computer. We do not accept no liability related to damage or loss caused by harmful programs or viruses, except in the event of gross negligence, or willful misconduct

 **Vendim_KSHZ_2025_129_Për shqyrtimin e kërkesës së datës 20.2.2025, të Organizatës Qendra "Qëndresa Qytetare"** .pdf
219K



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Tiranë më

Nr. _____ prot. _____

Data: 20.2.2025

Nr: 129

Ora: 16:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË DATËS 20.2.2025, TË ORGANIZATËS QENDRA
“QËNDRESA QYTETARE”**

Sot më datë 20.2.2025, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi mori në shqyrtim kërkesën me:

KËRKUES: Organizata Qendra “Qëndresa Qytetare”

OBJEKT: Kërkesë për ndalimin e veprimtarisë publike, takim i Kryeministrit me punonjësit e Bashkisë Tiranë.

BAZA LIGJORE: Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, dhe neni 92, të ligjit ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

KONSTATOJ:

Organizata Qendra “Qëndresa Qytetare”, më datë 20.2.2025, ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) nëpërmjet adresës së postës elektronike e-mail, kërkesën për ndalimin e veprimtarisë publike, takim i Kryeministrit me punonjësit e Bashkisë Tiranë.

Në këtë kërkesë Organizata Qendra “Qëndresa Qytetare” parashtrohet sa vijon:

Më datë 20.02.2025, jemi njoftuar përmes platformave të komunikimit elektronik dhe mediave të ndryshme se, në të njëjtën datë, në orën 16:30, Kryeministri do të zhvillojë një takim me punonjësit e Bashkisë Tiranë. Të dhënat e publikuara tregojnë se, në këtë takim do të marrë pjesë në mënyrë të organizuar dhe të detyruar e gjithë administrata e Bashkisë Tiranë, dhe secili prej drejtorive apo institucioneve në varësi të saj, do të mbajë përgjegjësi për vërtetësinë e numrit të stafit të pranishëm. Në kushtet kur veprimtaria e cituar më sipër, sipas të dhënave që disponojnë deri më tani, prezantohet si një veprimtari me karakter publik, që organizohet nga Kryeministri dhe që zhvillohet në periudhën

Data: 20.2.2025 Nr. 129
Ora: 16:00



“Për shqyrtimin e kërkesës së datës 20.2.2025, të
Organizatës Qendra “Qëndresa Qytetare”

katër mujore të parashikuar nga Kodi Zgjedhor, është e hapur për mediat dhe publikun, pra punonjësit e Bashkisë dhe institucioneve në varësi të saj, ajo përfshihet në kuptimin e "veprimtarive publike", në referim të pikës 1, të nenit 92, të Kodit Zgjedhor.

Për rrjedhojë, kjo veprimtari duhet të ishte raportuar nga ana e Kryeministrisë, në përputhje me nenin 92, të Kodit Zgjedhor. Nga verifikimi ynë në ndërfaqen elektronike të raportimeve NRI, rezulton se kjo veprimtari nuk është raportuar nga ana e organit përgjegjës. Përkundrazi, Kryeministria ka raportuar se të vetmet aktivitete publike që do të zhvillohen nga ana e institucionit në datën 20.02.2025, janë Inagurimi i Spitalit të Pediatriisë në Qendrën Spitalore Universitare Tiranë "Nënë Tereza" dhe Ceremonia e Hapjes së "Tirana, Kryeqyteti Mesdhetar i Kulturës dhe Dialogut 2025" (Prova Nr. 1 – Veprimtaritë e raportuara për t'u zhvilluar më datë 20.02.2025).

Më datë 14.2.2025, personi përgjegjës për raportimet të institucionit të Kryeministrisë, ka raportuar në përputhje me afatet ligjore të parashikuara në Kodin Zgjedhor, dy veprimtari me tematika si vijon:

1. **"Inagurimi i Spitalit të Pediatriisë në Qendrën Spitalore Universitare Tiranë "Nënë Tereza"**. Aktiviteti do të zhvillohet në 20.2.2025, ora 10:00. Vendi i zhvillimit të veprimtarisë: Njësia administrative nr. 3. Në këtë aktivitet është ftuar të marrë pjesë edhe Kryeministri i vendit, Z. Edi Rama.
Zhvillimi këtij aktiviteti është raportuar në datë 14.2.2025.
2. **Ceremonia e Hapjes "Tirana, Kryeqyteti Mesdhetar i Kulturës dhe Dialogut 2025"**. Në këtë ceremoni janë ftuar të marrin pjesë autoritete vendase dhe të huaj, ceremoni në të cilën do të jetë i pranishëm si i ftuar edhe Kryeministri i vendit Z. Edi Rama.
Veprimtaria është raportuar në datë 14.2.2025 për tu zhvilluar në datë 20.2.2025, ora 16:00, Vendi i zhvillimit të veprimtarisë: TKOB, njësia administrative nr. 2.

Nëpërmjet postës elektronike personi përgjegjës për raportimet të institucionit të Kryeministrisë në datë 19.2.2025 ka njoftuar për veprimtarinë e parë se: *"Inagurimi i Spitalit të Pediatriisë" se aktiviteti është shtyrë për në datën 21 shkurt, në orën 09:00"*.

Gjithashtu, po në datë 19.2.2025 në lidhje me veprimtarinë e dytë "Ceremonia e Hapjes "Tirana, Kryeqyteti Mesdhetar i Kulturës dhe Dialogut 2025" se: *"Për shkak të afërsisë së eventit është e pamundur ndryshimi në sistem i vendit ku do organizohet aktiviteti. Nga TKOB, vendndodhja e zhvillimit do të jetë Sheshi "Skënderbej", në orën 16:30, po në njësinë administrative nr. 2"*.

Përsa më sipër rezulton se të dy veprimtaritë e referuara në kërkesë, janë raportuar nga institucioni i Kryeministrisë dhe njoftimi për ndryshimin e kohës dhe vendit të organizimit të tyre është kryer nëpërmjet postës elektronike.

Tematikat e veprimtarive të raportuara nga Institucioni i Kryeministrisë nuk hyjnë në fushën e veprimtarive të ndaluara, të parashikuara nga neni 92, i Kodit Zgjedhor, si dhe Vendimi nr. 9/2020, i Komisionit Rregullator, i ndryshuar. Këto veprimtari janë raportuar në përputhje me parashikimet ligjore më sipër, e për rrjedhojë, nuk ka vend për ndalimin e secilës prej këtyre dy veprimtarive.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat "dh", "f" dhe "n", pika 2, dhe neni 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar,

Data: 20.2.2025 Nr: 129
Ora: 16:00



"Për shqyrtimin e kërkesës së datës 20.2.2025, të Organizatës Qendra "Qëndresa Qytetare"

VENDOS:

1. Mospranimin e kërkesës së Organizatës Qendra “Qëndresa Qytetare”, për ndalimin e veprimtarisë publike, “Takim i Kryeministrit me punonjësit e Bashkisë Tiranë”.
2. Ky vendim njoftohet nëpërmjet postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI





KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
RAPORTIM I AKTIVITETEVE

☰ Të raportuara

⚠ Të ndaluara

Veprimtaria



Institucioni

KRYEMINISTRIA

Të dhënat e veprimtarisë

Dt. e regjistrimit të veprimtarisë

14-02-2025, 17:36

Dt. e zhvillimit të veprimtarisë

20-02-2025

Ora e zhvillimit të veprimtarisë

16:00

Vendi i zhvillimit të veprimtarisë

Vendodhja:

Brenda Vendit

Qarku :

Tiranë

Bashkia :

Tiranë

Nj. administrative :

Njësia Administrative Nr. 2

Adresa :

TKOB

Lloji i veprimtarisë

Tjetër

Tematika e veprimtarisë

Kulturë

Sqarime mbi tematikën

Bashkia e Tiranës organizon ditën e enjte, 20.02.2025, Ceremoninë e Hapjes "Tirana, Kryeqyeti Mesdhetar i Kulturës dhe Dialogut 2025".

Tirana është shpallur "Kryeqyeti Mesdhetar i Kulturës dhe Dialogut 2025". Ceremonia si dhe shumë aktivitete të cilat do të pasojnë përgjatë vitit 2025 do të nxisin mirëkuptimin midis kulturave si dhe do të promovohen marrëdhëniet mes qyteteve evropiane të Mesdheut.

Folësit kryesorë

#	Emri	Mbiemri	Pozicioni
1.	SHTZ. Edi	Rama	Kryeministër
2.	Z. Blendi	Gonxhja	Ministër

#	Emri	Mbiemri	Pozicioni
3.	Z. Josph Ferre	Drejtori Ekzekutiv i Fondacionit Anna Lindh Foundation	Tjeter
4.	SHTZ. Hassan	Shawky Ambasador i Egjiptit në Tiranë	Diplomat i huaj

Pjesëmarrës të nivelit të lartë

i Veprimtaria nuk ka pjesëmarrës të nivelit të lartë!

Pjesëmarrës të tjerë

i Veprimtaria nuk ka pjesëmarrës të tjerë!



Sponsor i veprimtarisë

i Veprimtaria e zgjedhur nuk ka sponsor!

Statusi

Statusi i veprimtarisë:

Aktiv



Legjislacioni

- Kushtetuta
- Kodi Zgjedhor
- Ligji partitë politike
- Ligj dekriminalizimi

Transparenca

- Koordinatori
- Programi
- Modelet
- Informacione

